



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

nga

Takimi i Kolegjiumit për Inspeksionin Komunal

Vushtrri, 7 shkurt 2010

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiumit për Inspeksionin Komunal



7 shkurt 2011, Restorant 'Holiday', Vushtrri

HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Inspeksionin Komunal organizoi takimin e radhës së Inspeksionit Komunal. Takimi u mbajt me 7 shkurt 2011 në Restorantin "Holiday" në Vushtrri.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

1. Miratimi i Rregullores së Kolegjiut për Inspeksion dhe Planit të Punës 2011
2. Diskutim mbi „Ligjin mbi Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut“
3. Diskutim mbi „Ligjin për Duhanin“

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Drejtorive Komunale për Inspeksion të Kosovës, përfaqësues nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Kryeinspektor z. Ruzhdi Shehu, si dhe zv. Kryeinspektori Sanitar z. Ibrahim Tërshnjaku dhe përfaqësues të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiut për Inspeksion z. Bajram Beqiri.

PËRMBLEDHJE

z. Bajram Beqiri, Kryesues i Kolegjiut - përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim, veçanërisht zyrtarët nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe falënderoj zyrtarët e Asociacionit të Komunave të Kosovës për ndihmën e dhënë në organizimin e punës së Kolegjiut. Në fjalën e tij kryesuesi ceku angazhimin në planifikimin e punës së Kolegjiut, si dhe vizitat studimore nëpër Komuna të Kosovës. Pastaj i dhe fjalën Menaxherit të Programit të AKK z. Ertan Munoglu në njoftim të planit të punës për vitin 2011.

z. Munoglu prezantoi dokumentin udhëzues për përpilimin e planit të punës së Kolegjiut për Inspeksion për 2011, ku në pika të shkurta prezantoi: Strategjinë e AKK-së për periudhën 2011-2015, Prioritetet e Kolegjiut për Inspeksionin Komunal në vitin e kaluar (2010) dhe formatin e Planit të Punës për vitin 2011.

1. Miratimi i Rregullores së Kolegjiut për Inspeksion dhe Planit të Punës 2011

Kryesuesi prezantoi rendin e ditës dhe kërkoi deklarin e pjesëmarrësve rreth planit dhe rregullores së punës, nëse ka ndonjë vërejtje apo sugjerim para votimit.

z. Shefik Sylejmani - Viti: theksoi se duhet korigjuar Nenin 2 të Rregullores së Punës duke marrë parasysh që Kryesia është prej 7 anëtarëve, e jo 5. Me këtë vërejtje, Rregullorja e Punës së Kolegjiut u aprovua unanimisht.

Kryesuesi pastaj përmendi se në Kryesinë e Kolegjiut është një përfaqësues i ri nga Komuna e Rahovecit të cilin do ta njoftojë me punën dhe procedurat e Kolegjiut.

Në pajtim me të gjithë pjesëmarrësit u dakorduan që Kryesia e Kolegjiut të përgatis Planin e Punës 2011 dhe ta prezantoj për miratim në takimin e radhës.

2. Diskutim mbi „Ligjin mbi Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut“

Në vazhdim kryesuesi informoj të pranishmit se prezent janë edhe dy zyrtarë të MTI-së, respektivisht Kryeinspektori z. Ruzhdi Shehu dhe zv. kryeinspektori sanitar z. Ibrahim Tërshnjaku ku mund ti parashtroni pyetje në lidhje me ligjin në fjalë. Po ashtu përmendi se Asociacioni ka bërë një kundërshtim për ligjin në fjalë, ku edhe ka kërkuar rishikim të ligjit, sepse duhet të shqyrtohen disa pika të saj për shkakun e zhveshjes së përgjegjësive të inspektoratit komunal.

z. Ruzhdi Shehu-Kryeinspektor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë: theksoi se ligji i shfuqizuar për Inspektoratin e Tregut i aprovuar me 2005, gjatë praktikës së punës ka hasur në pengesa për shkak të inspektimit të dyfishtë, në nivel të Komunave dhe MTI-së. Andaj ekspertët vendor dhe të huaj kanë dhënë sugjerime për ndryshimin e tij sipas rekomandimeve të BE. Përmes një donacioni janë siguruar ekspert ndërkombëtarë për përpilimin e këtij ligji në një proces të gjerë konsultativ me Ministrinë e Linjës (përfshirë MAPL), Odat Ekonomike, si dhe grupet e interesit. Avantazh i këtij ligji është nxitja e investimeve të reja në vend, një qasje dhe kontroll unik të tregut në tërë vendin, zvogëlimi i shpenzimeve nga evitimi i inspektimeve të dyfishta, etj. Sipas ligjit të ri, inspektimi tregut do të jetë nën një ombrellë dhe përgjegjësitë e inspektorëve do të jenë më të definuara.

Kryesuesi theksoi se ende nuk ka filluar zbatimin e këtij ligji, dhe se Bordi i AKK-së ka rekomanduar komunat të mos nënshkruajnë Memorandumin e Mirëkuptimit të propozuar nga MTI. Prandaj, Kolegjiumi duhet ti jap opinionet e veta për këtë ligj. z. Munoglu sqaroi se as AKK e as Komunitet nuk kanë qenë të konsultuara në procesin e hartimit të këtij ligji, andaj AKK ka kërkuar të mos nënshkruhet ky Memorandum dhe të ndryshohet ky ligj duke i kthyer kompetencat në komuna.

z. Shehu tha se ky ligj i është nënshtruar të gjitha procedurave legjislative dhe se Kryetarët nuk marrin pjesë në grupet punuese, si grupi punues i cili ka hartuar ligjin në fjalë me kërkesë të Zyrës së Kryeministrit. Ai shprehi keqardhje për shkak të mos informimit të Kryetarëve dhe AKK-së, dhe potencioi se asnjë grup politik nuk ka pasur asnjë kundërshtim në këtë drejtim.

z. Jahir Tafaj - Suharekë: kërkoi nga kryeinspektori të sqarojë nenin 38 të këtij ligji. z. Shehu sqaroi se ka mungesë të akteve nënligjore për zbatim të nenit 38 dhe se në bashkëpunim me qeverinë kjo do të kompletohet dhe aktet në fjalë do t'i shpërndahen inspektorëve edhe përmes AKK-së. MTI në bashkëpunim me ekspertin Slloven do të ofroj trajnime edhe rreth praktikave të mira të BE-së në këtë fushë.

z. Tafaj më tutje shtoi se centralizimi i kompetencave të inspektoratit të tregut zvogëlojnë të hyrat komunale që vijnë nga p.sh taksat nga asgjësimi i mallrave, nga shitja e mallrave të konfiskuara, etj. z. Ibrahim Tërshnjaku - zv. Kryeinspektor Sanitar: tha se procedurat dallojnë nga kompetencat dhe se inspektorët vetëm kryejnë procedurat dhe nuk janë kompetent për konfiskim dhe sigurim të të hyrave. Të hyrat nga konfiskimi nuk janë të hyra komunale sepse ato shkojnë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Ai poashtu theksoi se sipas ligjit të ri, kërkohen 5 trajnime në vit për certifikimin e inspektorëve, ndërsa testimi duhet të bëhet çdo 3 vjet. z. Shehu sqaroi se malli i konfiskuar deponohet në një depo në nivel të Kosovës dhe për menaxhimin e atij malli pastaj merret një agjension tjetër, e jo

inspektorët. Ai poashtu shtoi se nëpër komuna ka laramani të madhe të rregulloreve të cilat në kundërshtim me ligjet në fuqi autorizojnë organet komunale me shumë përgjegjësi tjera shtesë.

z. Shefik Sylejmani - Viti: ligji i ri ka ndryshim vetëm në mbledhjen e kompetencave si dhe në bartjen e inspektorëve në nivel qendror. Deri më tash niveli qendror nuk ka konsultuar apo ofruar trajnime inspektorëve komunal, por vetëm ka dërguar urdhra. Për më tepër nuk ka pasur koordinim në mes të nivelit qendror (Agjensionit për Veterinari dhe Ushqim të Kosovës – AVUK) dhe atij lokal edhe si rezultat nuk ka pasur qarkullim të mjaftueshëm të informacionit. Ai theksoi se nuk ka asgjë të keqe në inspektimit të dyfishtë, sepse kjo siguron një lloj kontrole dhe po ashtu mbulesë për inspektorët komunal. Sa i përket ligjit të ri, duhet të ketë një konsultim me komunat, sepse MTI nuk ka ftuar në një debat Kryetarët apo komunat. Autoriteti duhet të jetë sa më afër komunës sepse autoritete lokale i dinë më mirë problemet lokale. Z. Shehu u përgjigj se për shkak të mos-koordinimit nuk ka funksionuar ligji i vjetër dhe prandaj është bërë ligji i ri. Ligji i ri ofron kompetenca të njëjta, por nën një ombrellë me çka edhe garantohet mbrojtja e konsumatorëve sipas kërkesave të BE-së. z. Tërshnjaku shtoi se sipas vizitave studimore dhe rekomandimeve të BE-së duhet të ketë një politikë të centralizuar inspektorati që do të zbatohet në të gjitha komunat. Si shembull mund të merret Administrata Tatimore e Kosovës e cila ka pasur sukses si një qendër e vetme në inspektim të tatimeve.

Kryesuesi theksoi se Drejtorët kërkojnë nga inspektorët të inkasojnë të hyra, prandaj Drejtorët duhet të këshillohen që kjo nuk është detyrë e inspektorëve dhe të mos kemi shkelje të ligjit.

z. Tafaj tha se MAPL bën certifikimin e rregulloreve komunale nëse janë në përputhje me ligjet në fuqi, dhe në ende kemi dyshime rreth nenit 38. Ndërsa sa i përket komunikimit me nivelin qendror, ai duhet të përmirësohet dhe të ketë një koordinim më të mirë.

z. Tërshnjaku sqaroi se ky ligj është bërë centralist edhe për shkak të koeficienteve të inspektorëve të cilët ndryshojnë nga komuna në komunë prej 5 deri në 9 varësisht nga sistematizimi i punës, ndërsa disa marrin kompensim për rrezikshmëri e disa jo. Me ligj të ri inspektorët do të ketë një vijë të vetme operimi në përputhje me ligjet në fuqi, e jo në bazë të rregulloreve komunale të cilat janë në kundërshtim të ligjit. z. Shehu shtoi se Qeveria ka ngritur një grup punues për harmonizimin e rregulloreve komunale me ligjet në fuqi, me çka do të ketë një punë më efektive dhe një bashkëpunim më të mirë me komunat.

z. Bajram Rizani - Lipjan: pyeti se kur do të fillohet me lëshimin e lejeve të punës dhe shtoi se bashkëpunimi me MTI-në kanë munguar sepse inspektorët qendror nuk kanë konsultuar komunat me kohë. Për më tepër ka kolizion edhe në mes të ligjeve, gjë që kërkon zgjidhje. z. Shehu u përgjigj se Ligji i tregut të brendshëm duhet të ndryshoj. Sipas Bankës Botërore, një biznesi i duhen 60 ditë për nxjerrjen e lejes së punës, dhe ndryshimet janë të domosdoshme për të lehtësuar këtë proces. Lëshimi i lejeve të punës do të mbetet kompetencë komunale dhe të gjitha të hyrat nga kjo do të marrin komunat.

z. Aledin Aliu – Dragash: pyeti Kryeinspektorin si të veprojnë inspektorët kur afatet ligjore nuk janë definuar në ligjin e ri? z. Shehu tha se këtë çështje e rregullon ligji i procedurave administrative. I mbetet inspektorit të gjykojë afatin brenda cilit klienti duhet të rregullojë një problem, por ky afat nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.

z. Shemsedin Maksuti - Skenderaj: nuk ka një bashkëpunim të mirëfilltë me nivelin qendror, dhe tani inspektorët duhet të dinë se sa eprorë do të kenë (a do të jenë dy: nivel lokal dhe qendror?) dhe kujt duhet ti raportojnë. z. Shehu u përgjigj se kjo ka shkaktuar telashe në të kaluarën, por tani inspektorët do të kenë vetëm një eprorë në vijë vertikale në kuadër të Qeverisë.

z. Jashar Hulaj - Deçan: ka pasur një bashkëpunim me të gjitha nivelet, por problemet mbeten tek rregulloret komunale të cilat dallojnë nga komuna në komunë (p.sh. regjistrimin e bizneseve, licencat, tarifat, etj). Një shqetësim tjetër është se komuna e Deçanit nuk ka inspektorë të veterinarisë, dhe pyetja është se a do të kompletoj tani MTI këtë fushë? z. Tërshnjaku tha se disa komuna (përfshirë Prishtinën me rreth 500,000 banorë) nuk kanë inspektorë për veterinarin, prandaj do të ketë një unifikim rreth kësaj çështjeje.

3. Diskutim mbi „Ligjin për Duhanin“

Kryesuesi theksoi se sipas disa informatave nga terreni, deri më tash zbatimimi i ligjit ka ecur mirë.

z. Tërshnjaku: kemi një bashkëpunim të mirë me të gjithë aktorët. BE kushtëzon zbatimin sa më të mirë të këtij ligji për investime të mëtutjeshme. Pritet që deri në fund të vitit të zbatohet rreth 60% e ligjit.

z. Aziz Sylejmani - Shtime: dispozitat e nenit 13.2 dhe 13.4 parashohin gjobitjen e personave juridik prej 5,000 – 10,000 EUR, mirëpo shumica e bizneseve janë biznese individuale, e jo persona juridik. Prandaj inspektorët nuk mund të gjobisin këto biznese për shkelje të ligjit! Ai poashtu pyeti se kush duhet t'i shqipton gjobat: gjykata apo inspektori? z. Tërshnjaku u përgjigj duke thënë se shqiptimi i gjobave bëhet nga inspektori ndërsa ekzekutimi nga gjykata.

z. Ismet Hajdini - Gjilan: është e vështirë për kushtet tona ndarja e 30% të hapësirës, prandaj do të ishte mirë të bëhej ndarja e vendeve ku pihet duhani tërësisht apo aspak, sikur në disa vende të BE-së. z. Tërshnjaku shpjegoi se aty ku nuk është e mundur ndarja, duhet ndaluar pirjen e duhanit në tërësi. Ky është një ligj është parapërgatitje, sepse pas 2-3 viteve do të ndryshoj ligji dhe ndoshta të ndalet pirja e duhanit në tërësi në vendet publike.

z. Ismet Kafexholli - Malisheva: si do të bëhet pagesa e gjobave prej 20 EUR për personave të cilët nuk respektojnë rregullat e përcaktuara: me para në dorë apo në gjykata? z. Tërshnjaku tha se inspektori duhet të bëjë fletëparaqitje për gjykatën, kurse gjykata do të jetë ajo që do ta ekzekutojë vendimin. z. Shehu shtoi se inspektorët nuk mund të marrin para në dorë, dhe se gjobitësi duhet të bëjë pagesën në xhironlogari në një afat të caktuar kohor. Nëse pagesa nuk paguhet në afat, lënda duhet të procedohet në gjykatë. z. Kafexholli tha se do të ishte mirë inspektori të ketë një bllok për gjobat sikurse policët, në mënyrë që lëndët të mos shkojnë në gjykatë.

REKOMANDIMET

- Kryesuesi të informojë anëtarin e ri të Kryesisë nga Komuna e Rahovecit me punën dhe procedurat e Kolegjiumit
- Kryesia e Kolegjiumit të përgatis Planin e Punës për vitin 2011

- Të harmonizohet Ligji për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut me kërkesat e komunave dhe AKK-së për plotësim-ndryshim.
- Përfshirja e AKK-së në grupin punues të Qeverisë për harmonizimin e rregulloreve komunale për inspektorat me ligjet relevante
- Të kompletohet inspektorati i veterinarisë në nivel komunal